



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-14-0115

M.Sh. Prizren.

Ankuesi/Paditësi

Përfaqësuar nga av. Prizren.

Kundër:

NSH. Prizren.

E paditura

Administruar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit - AKP**, Rr. "Agim
Ramadani", nr.23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues, Mr.sc Sahit Sylejmani, dhe Hajrie Shala, Gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendim të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-12-0673 të datës 11 mars 2014, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 tetor 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit, aprovohet si e bazuar.**
- 2. Anulohet, Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-12-0673 të datës 11 mars 2014.**
- 3. Lënda kthehet për rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 21 maj 2007, paditësi dorëzoi padi në Gjykatën Komunale në Prizren për anulimin e kontratës së shitblerjes dhe kthimin e patundshmërisë.

Sipas paditësit me kontratën e shitblerjes së patundshmërisë, Leg nr.2286/63, të datës 11.12.1963, patundshmëria e regjistruar si p.k.nr 6676, me sipërfaqe prej 0.32,65 ha dhe p.k.nr.6677, me sipërfaqe prej 0.25,09 ha, nga L.p.nr.8417ZK Prizren kanë kaluar në pronësi të paditurit. Më tutje, pretendon se kjo shitblerje është bërë në kundërshtim me vullnetin e ish pronares F.Sh. e cila ka qenë pa shkollë dhe nuk ka ditur shkrim dhe lexim në Gjuhën Serbe. Aktivistet e atëhershëm komunist nën presion dhe kundër vullnetit të saj, transferuan këtë patundshmëri edhe pse e njëjta ka qenë buzë vdekjes duke e lënë si trashëgimtar paditësin.

Paditësi kërkon aprovimin e padisë dhe detyrohet e paditura që paditësit ti dorëzoji ngastrat kadastrale në pronësi dhe shfrytëzim të lirë.

Më 27 prill 2011, Gjykata Komunale në Prizren me Aktvendim C.nr.371/07, shpalli vetën jo kompetentë në pikëpamje lëndore dhe lëndën e transferon për vendosje në Dhomën e Posaçme, si Gjykatë kompetente për të gjykuar këtë çështje juridike.

Më 19 prill 2012, DHPGJS me Aktvendim SR-11-0146, lëndë C.nr.371/07 , e pranoi në kompetencë pasi në këtë lëndë ka kompetencë ekskluzive. Lënda u regjistrua nën numrin e ri C-III-12-0673.

Më 11 dhjetor 2011, DHPGJS dorëzoi urdhrin tek paditësi duke kërkuar që në afat prej 21 ditësh, të dorëzoj padinë e korigjuar dhe të plotësuar të adresuar në DHPGJS në pajtim me nenet 25,27 dhe 28 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme, dëshmi që AKP ishte njoftuar para parashtrimit të padisë së re në

DHPGJS, autorizimi për përfaqësimin e paditësit në procedurat para DHPGJS sipas nenit 24.1 të Shtojcës së LDHP si dhe padinë dhe të gjitha dokumentet përcjellëse të parashtruara më padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit dhe padinë e korigjuar të përkthyer në Gjuhën Angleze. Paditësi ishte njoftuar për të drejtat e tij për të paraqitur kërkesë për ndihmë në përkthim dhe ishte në dijeni për pasojat në rast të mos-përmbushjes së urdhrit.

Përfaqësuesi i paditësit dorëzoi një përgjigje por jo në mënyrë të plotë siç ishte urdhëruar. Në të cilën ka parashtruar vetëm padinë e korigjuar dhe të plotësuar të adresuar në DHPGJS ,Certifikatë Vdekjeje për F.Sh. 23.07.1995 , M.H. 16.07.1945, Ekstrakt i lindjes M.Sh. 11.02.1867, S.Sj. 01.07.1942 dhe autorizimin e përfaqësimit të av. Y.K.

Më datën 11 mars 2014, merret, Aktvendimi, C-III-12-0673 me të cilin padia e paditësit hedhet poshtë si e papranueshme, paditësi nuk ka dorëzuar përkthimin në gjuhën angleze të padisë dhe dokumenteve të tjera mbështetëse dhe nuk ka paraqitur as kërkesë për ndihmë në përkthim, e cila parashihet edhe ne bazë të nenit 25.8,8, i Shtojcës së Ligjit të DHPGJS. Në pajtim me nenet 24.1, 28.1 dhe 28.3 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme padia e paditësit hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Më datën 07 prill 2014, paditësi ka parashtruar ankesë në DHPGJS për shkak të të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që ankesa e paditësit të pranohet dhe Aktvendimi i goditur C-III-12-0673 të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim Gjykatës së shkallës së parë. Paditësi pretendoi se është i padrejtë pasi që duke u bazuar në nenin 5 të Kushtetutës së RKS-së çdo qytetar i Kosovës i është garantuar përdorimi i Gjuhës së vet amtare-konkretisht në këtë rast përdorimi i Gjuhës Shqipe.

Më datë 16 gusht 2016, AKP jep përgjigje në ankesë dhe thekson se i kundërshton pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesën e tij, AKP-ja i propozon Kolegjit të Apelit pranë DHPGJS-së që pas administrimit, shqyrtimit, vlerësimit të provave

ta refuzoj ankesën e paditësit në tërësi si të pabazuar. Sipas AKP-së ankuesi as me ankesë nuk ka arritur të paraqes ndonjë bazë ligjore. Gjithashtu AKP-ja kërkon nga Kolegji i Apelit refuzohet në tërësi ankesa dhe të aprovohet Aktvendimi i atakuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e bazuar.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

Kolegji i Apelit vëren se ankuesi para Kolegjit të Specializuar ka dorëzuar padinë e korigjuar dhe të plotësuar të adresuar në DHPGJS Certifikatë Vdekjeje për F.Sh.23.07.1995 ,M.H. 16.07.1945, Ekstrakt i lindjes M.Sh. 11.02.1867, S.Sj. 01.07.1942 dhe autorizimin e përfaqësimit të av. Y.K. dhe jo padinë e korigjuar të përkthyer në Gjuhën Angleze. Siç është kërkuar nga Kolegji i Specializuar .

Po ashtu Kolegji i Apelit vlerëson se dështimi i ankuesit për përkthimin e dokumenteve nuk ishte arsye e saktë për hedhjen e ankesës si të papranueshme.

Sipas nenit 25.10 të LDHP-së, Kolegji i Specializuar ka mundur te përktheje dokumentet edhe vetë dhe te ngarkoj me shpenzime ankuesin.

Për më tepër ,tani kur pas ndryshimit të LDHP-së lidhur me përkthimet nuk mund të merret si arsye valide ligjore për hedhje të kërkesës si të pa pranueshme.

Në nenin 2 i Ligjit nr.04/L-246 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme i aplikueshëm nga 19 prilli 2014 parashihet që: Neni 25.8 i Shtojcës së ligjit bazik ,paragrafi 8.riformulohet me tekstin si në vijim:" 8. Të gjitha kërkesat dhe dokumentet përcjellëse paraqitën në gjuhën shqipe dhe serbe, kurse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të sigurojë me propozimin dhe burimet e saj, përkthimin e tyre në gjuhën angleze".

Andaj nga këto arsya të mësipërme ligjore hudhja poshtë e ankesës si e pa pranueshme vetëm se ankuesi nuk ka përkthyer ankesën me dokumente mbështetëse si dhe mungesën e përfaqësuesit me autorizimin nuk janë të sakta.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dipozitiv.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27.03.2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive në lëndët në pritje.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit me datë 24 tetor 2019

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT

Lutemi të dërgoni këtë Aktvendim tek:

- Ankuesi
- Agjencinë Kosovare të Privatizimit ,
- Gjyqtari Kryesues i Kolegjit të Specializuar, në lëndën numër C-III-12-0673

Ilmi Bajrami, Kryesues i Kolegjit _____